

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit G.H., për shkak të veprës penale asgjësim ose dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1896/17 të datës 24.10.2017, të cilin e përfaqësonte prokurori Shefik Memeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 16.02.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri G.H. nga babai E. dhe nëna Xh., e lindur I., i lindur më data e lindjes... në fshatin ... K.... ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, gjendja ekonomike e varfër, shqiptar, shtetas I Republikës së Kosovës.

**Është fajtor
Sepse**

Me datë ..., rreth orës 13.30, në ... në rrugën “ ... ” përballë restorant “ ... ” ka dëmtuar dhe pantallonat e të dëmtuarit Z.K. nga fsh. ... K. ... dhe pasqyrën e derës së kamionit të kompanisë KNPSH “ ... ” SH.P.K, në atë mënyrë që fillimisht fyen të dëmtuarin Z. e më pas e gjuan me telefon dhe shkon e ia hapë derën e kamionit të njëjtit dhe e tërheq për këmbë që ta zbres në tokë dhe me këtë rast ia shqepë pantallonat në këmbën e majtë me ç’rast ndërhyjnë disa punëtorë që ishin aty dhe ai largohet, por më pas merr një gurë dhe të njëjtin e gjuan dhe ia thyen pasqyrën e derës së shoferit, me ç’rast pronarit të të dëmtuarit Zijandin i shkakton dëm në vlerë të pa përcaktuar në pantallona, kurse KNPSH- “ ... SH.P.K, shkakton një dëm në vlerë përafërsisht rreth 150€.

- me çka ka kryer veprë penale **asgjësim ose dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenet 4,7,17,21,49,50,51,52,73,74 të KPRK-së, si dhe të neneve 365 dhe 451 të KPPRK-së, atij i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I. Ashtu që të pandehurit G.H. i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1 (një) viti nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

II. Të dëmtuarit Z.K. dhe përfaqësuesi i kompanisë “ ... ” SH.P.K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit G.H., për shkak të veprës penale asgjësim ose dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës së lartcekur i pandehuri G.H., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranohet fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, duke shtuar se më vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë një gjë të tillë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të Prokurorit të Shtetit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri G.H., nga fsh. ... K. ..., ka kryer veprën penale asgjësim ose dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit G.H., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljen shumë të mirë të tij gjatë shqyrtimit fillestar, se i pandehuri ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër

tjetër penale, si dhe faktin se i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit G.H., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 ndërsa ai mbi kërkesën pasurore-juridike, në nenin 463 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.1133/17 më 16.02.2018

Zyrtarja ligjore,
Florentina Ademi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*